



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I BASHKISE SE QYTETIT KORÇE

Vendim

Nr 35 datë 06/05/2010

Për dhënien e autorizimit për kryerjen e procedurave për shpronësimin e pasurisë private që preket nga kalimi i tubacionit kryesor i ujrave të përdorura të qytetit të Korçës” .

Këshili Bashkiak pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike dhe mbas diskutimit të keshilltareve ,mbështetur në nenin 32 pika k të ligjit 8652 date 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionim e qeverisjes vendore”,nenit 7/3 te ligjit Nr.8561 datë 22.12.1999”Per shpronësimet dhe marrjen ne perdorim te perkohshem te pasurisë pronë private,per interes publik” VKM-se Nr.872 datë 121.12.2007 “Per disa ndyshime dhe shtesa ne vendimin Nr.138 datë 23.03.2000 te Keshillit te Ministrave “Per kriteret teknike te vleresimit dhe perlllogatitjes se mases se shperblimit te pasurive ,qe zhvleresohen dhe te drejtave te personave te trete per interes publik”.

VENDOSI:

1. Ti japë autorizim Bashkise Korçe te kryeje procedurat e shpronësimit te pasurise private (me numer pasurie 8/148,ne zonen kadastrale 8561), që preket nga kalimi i tubacionit kryesor i ujrave te perdorura te qytetit te Korçes .
2. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Shoqeria Aksionare “Ujesjellës Kanalizimeve Korçë”
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari
Gjergji PENDAVINJI